



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 13 korrik 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Ramush Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Munguan: Teuta Rugova, Puhie Demaku.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Me ftesë të Komisionit, në mbledhje ishte prezent Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, në përbërje prej: z. Murat Meha, AKK - kryesues; Besim Kajtazi, ZKM - anëtar; Shaban Guda, MPB- anëtar dhe Dasar Krasniqi, ZKM.

Pjesëmarrës të tjerë: Albulena Haxhiu - deputete, GP-VV; Sanije Berisha- OSBE, Gurjeta Zeka - VV; Bashmir Xhemaj- këshilltar dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit me Malin e Zi;
3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 4, 8, 12, 15 dhe 21 maj 2015;
4. Njoftim nga vizita zyrtare e grupit punues;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Enver Hoxhaj – Propozoi që pika e 4-t e rendit të ditës, të shtyhet për një mbledhje tjetër, meqë nuk është prezent deputetja Puhie Demaku, kryesuese e grupit të punës.

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës, me propozimin që të shtyhet për mbledhjen e radhës pika e 4-t e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 4, 8, 12, 15 dhe 21 maj 2015

Kryetari konstatoi se, Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 4, 8, 12, 15 dhe 21 maj 2015.

3. Raportim i Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit me Malin e Zi

Enver Hoxhaj– Njoftoi se në mediat malazeze, thuhet se ka një marrëveshje të nënshkruar për çështjen e kufirit, mirëpo kjo nuk është e vërtetë, meqë marrëveshja duhet të nënshkruhet në mes të dy qeverive dhe se kjo marrëveshje është marrëveshje ndërkombëtare, e cila duhet të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës, me qëllim që të jetë e plotfuqishme. Po ashtu, njoftoi se Komisioni nga Republika e Kosovës dhe nga Republika e Malit të Zi, janë marrë me aspektet teknike.

Z. Hoxhaj tha se kjo është një ngjarje e rëndësishme ndërkombëtare, meqë është përcaktim i kufirit bilateral me Malin e Zi, është kyç sa i takon sovranitetit të Kosovës, bashkëpunimit rajonal dhe fqinjësisë së mirë, por në të njëjtën kohë, është kyç edhe sa i takon procesit të liberalizimit të vizave dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit.

Më tej, njoftoi se ka dokumente legale të kohës, ka dëshmi historike, ka harta gjeografike dhe kadastrale, ka matje në terren, të bërë nga Komisioni për shënjimin e kufirit dhe se kjo është një vazhdimësi dhe nuk ka shumë dilema, por ka shqetësime. Ne jemi këtu që këto shqetësime t'i trajtojmë në një rrafsh sa më profesional.

Puna e këtij Komisioni ka qenë që vija kufitare, e cila është në hartë, të vendoset në tokë. Gjatësia e kësaj vije kufitare është 79 km.

Murat Meha – Njoftoi se Komisioni për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror është formuar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 21 mars 2012, bazuar në Ligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, ku ndër të tjera thuhet se Komisioni shtetëror do të bëjë shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror sipas marrëveshjes ndërkombëtare. Më tej, njoftoi se Komisioni e ka për detyrë teknike, që të ofrojë dokumentacion, të bëjë analizën e gjithë dokumentacionit shtetëror dhe t'i përgjigjet Qeverisë së Kosovës.

z. Meha tha se elementet kryesore për të hulumtuar, trajtuar, analizuar dhe sjellë rezultate, janë bazuar në Kushtetutën e vitit 1974 dhe në marrëveshjen ndërkombëtare që është pakoja e Ahtisaarit, ku thuhet se kufiri me fqinjët e Kosovës, është ai që është i gjetur më 31 dhjetor 1988.

Besim Kajtazi – Tha se si çdo marrëveshje edhe kjo marrëveshje, sipas nenit 18 të Kushtetutës, do të ratifikohet nga Kuvendi i Kosovës, sepse ka të bëjë me territorin e Republikës së Kosovës.

Njoftoi për marrëveshjen paraprake me Republikën e Maqedonisë lidhur me përcaktimin e kufirit, si dhe me Malin e Zi, ku fillimisht janë krijuar rregulla të përbashkëta të punës së dy komisioneve respektive shtetërore. Në këto rregulla të punës së komisioneve, janë përcaktuar edhe hartat që do të merren parasysh nga komisionet respektive, por edhe format dhe mënyrat e korrigjimeve.

Po ashtu, njoftoi se paralelisht kanë punuar edhe me komisionin trepalësh, ku është filluar me kufirin “tresh”, sepse ajo do të jetë një marrëveshje e veçantë, e cila do të paraqitet në tri parlamentet respektive.

Murat Meha – Përmes monitorit shpjegoi kufirin e tërësishëm të Republikës së Kosovës, i cili sipas Kushtetutës të vitit 1974, sipas dokumentacionit dhe hartave, është ai që paraqitet në monitor. Z. Meha paraqiti një hartë, për të cilën tha se është nga ish-Drejtoria për Gjeodezi e Krahinës Socialiste Autonome e Kosovës. Përveç kësaj harte, tha se kemi edhe harta të tjera zyrtare, të cilat e japin territorin e Kosovës të punuar në vitin 1973, e cila është identike me atë të paraqitur paraprakisht. Pastaj tha se kemi edhe hartën tjetër të punuar në 1973, ku janë bërë sektorët trigonometrikë, të cilët tregojnë kufirin e Kosovës shumë qartë, të saktë, preciz dhe të shfrytëzueshëm.

Të gjitha hartat që i kemi, janë të azhurnuara dhe të vërtetuara në zyrat e kadastrave të Komunës së Pejës, në zyrat e kadastrave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe në të gjitha institucionet ku kanë dokumentacion relevant. Njoftoi se Agjencia e Pyjeve ka sjellë fletë poseduese dhe ka sjellë harta, duke thënë se kjo po shkon deri në Mal të Zi. Ato fleta poseduese janë trajtuar dhe është vërejtur se ato prona janë brenda territorit të Kosovës.

Po ashtu, z. Meha shtoi se Komuna e Deçanit, e Junikut, por edhe disa banorë të Pejës, që kanë pasur prona në anën e Malit të Zi, të njëjtit janë pajisur me fletat poseduese, të cilat ua kemi siguruar nga Mali i Zi për të gjithë ata që kanë pasur materiale, 37 prej tyre i kanë kufizuar pronat e tyre me Malin e Zi. Me këto harta, tha se janë të njoftuar kryetarët e komunave dhe ua kemi sqaruar se ku është kufiri.

Ramush Haradinaj – Pyeti z. Meha lidhur me vijën e shënuar të kufirit: A e keni propozuar ju apo ua kanë prurë, a keni dërguar ndonjë variant të tuajin dhe se a e dini se ku ka qenë kufiri? Ai nuk u pajtua me njoftimet nga z. Meha, duke theksuar se edhe kryetarët e komunave, iu kanë treguar se jeni në gabim.

Murat Meha – Njoftoi se këto të dhënat janë në Komunën e Pejës, dhe se në takimet zyrtare, qytetarët thonë se e dimë ku është kufiri, por kemi pasur kullosa. Në kërkesën e qytetarëve, drejtuar Kuvendit të Kosovës, tha se kërkohet që t'i drejtohem Malit të Zi, që të lejohet shfrytëzimi i kullosave, sepse vazhdimisht janë paguar tatimet.

Elmi Reçica – Ne duhet ta dimë që kur kemi shtet, duhet ta ruajmë kufirin dhe kufiri është çështje shumë e ndjeshme dhe është çështje që do të duhej që të gjitha institucionet, por veçanërisht institucionet që janë të thirrura, domosdo të kenë kujdes dhe njëkohësisht të jenë shumë koshientë se janë duke e mbrojtur shtetin dhe kufirin e tij.

Më tej, shtoi se nga interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme, z. Hashim Thaçi, është dalë me një rezolutë, ku një nga pikat e kësaj është edhe bashkëbisedimi me Komisionin shtetëror.

Po ashtu, z. Reçica tha se e mbështesim këtë Komision, por i njëjti duhet të jetë i përgjegjshëm dhe secila marrëveshje që të ratifikohet në Kuvend, duhet të jetë e pranueshme për deputetët dhe për qytetarët e këtij vendi, dhe shtoi se kjo marrëveshje duhet të bazohet në ndarjen territoriale dhe administrative në bazë të Kushtetutës së vitit 1974.

Z. Reçica tha se Komisioni shtetëror e ka besimin e deputetëve, të qytetarëve, të institucioneve shtetërore, mirëpo ky besim duhet ta ngarkojë më shumë në përgjegjësi, për veprimet dhe për vendimet që i merr.

Ismet Beqiri – Tha se kur flasim për territorin e vendit, të gjithë kemi shqetësime, njëkohësisht kemi edhe obligim të mbrojmë atë që mund të mbrohet. Në fund, është Kuvendi i Kosovës ai që duhet të thotë fjalën e vet dhe të ratifikojë marrëveshjen. Pyeti z. Meha se sipas vlerësimit dhe dokumentacionit që ka, a dëmtohet kufiri i Kosovës, ky kufi i garantuar në vitin 1974 dhe me pakon e Ahtisaarit.

Albulena Haxhiu – Njoftoi se nuk është anëtare e këtij Komisioni, por për shkak të rëndësisë që ka kjo çështje, ka shprehur interes që të marrë pjesë dhe t'i japë disa argumente të Lëvizjes Vetëvendosje.

Haxhiu tha se demarkacioni me Malin e Zi mund të ketë fatin e njëjtë sikur ai me Maqedoninë, ndoshta edhe më keq, nëse nuk ndërmerren të gjithë mekanizmat për një demarkacion bilateral dhe korrekt.

Më tej, shtoi se komuniteti atje nuk është i shqetësuar vetëm për shkak të kullosave, por për territorin e Republikës së Kosovës, sepse territori është njëri prej elementeve themeltare të shtetësisë.

Duke iu referuar z. Meha, tha se po e paraqet çështjen në atë drejtim që po bëhet fjalë thjesht për disa kullosa, dhe jo për pronën e Republikës së Kosovës.

Pyeti z. Meha se cilat janë pikat referuese gjatë përcaktimit të kufirit, pasi që konfirmimi i kufijve në ish- RFSJ, nuk ka ndryshuar e as lëvizur kufijtë ekzistues që nga viti 1959. A janë të sakta informatat se jeni duke iniciuar referencat territoriale sipas përshkrimit të kufirit të vitit 1931, gjatë mbretërisë serbo-kroate-slllovene dhe vitit 1974, ku Kosova e merr statusin e krahinës autonome, me përfaqësim në kryesinë federale të ish-Jugosllavisë?

Njoftoi se sipas banorëve, forcat kufitare të Malit të Zi janë prezentë në territorin e Republikës së Kosovës.

Zafir Berisha – Tha se në kontekstin historik, shqiptarët vazhdimisht janë cunguar në territore dhe ky mund të jetë aduti për reagime edhe të qytetarëve, edhe të njerëzve të jetës politike, duke theksuar se kufiri natyror është diku afër Tivarit. Kërkoj të informohet nga përfaqësuesit e Komisionit shtetëror se cila është fillimisht arsyeja e reagimit të qytetarëve të asaj ane. Po ashtu, kërkoj që prona jonë, të ruhet sipas dokumenteve të cilat i posedojmë dhe të vazhdohet me ruajtjen dhe kultivimin e mëtutjeshëm të raporteve me Malin e Zi.

Enver Hoxhaj – Komisioni për Punë të Jashtme, realisht duhet të shqetësohet nëse ka probleme me kufijtë e shteteve të tjera dhe kërkoj nga Komisioni shtetëror për shënjimin e kufirit që të njoftojë me indikatorë të saktë, se sa është operuar deri më tani, në këtë drejtim.

Blerta Deliu- Kodra – Mes tjerash, tha se ky takim ka për qëllim që t'u japë një përgjigje shqetësimeve të shumta të qytetarëve tanë. Ka shqetësime të qytetarëve të Pejës dhe Rugovës, të cilët kanë shprehur dyshimin se demarkacioni me kufirin e shtetit fqinj, do të prekë edhe një pjesë të tokave të tyre. Shtroi pyetjen për Komisionin shtetëror për shënjimin e kufirit se me demarkacionin e kufirit a do të ketë apo jo lëvizje të kufirit.

Qerim Bajrami – Në diskutimin e tij, pyeti përfaqësuesin e Komisionit shtetëror: A kanë kontaktuar me grupet joformale në terren dhe sa janë të argumentuara shqetësimet e tyre?

Murat Meha – Theksoi se nuk ka mjet as forcë që e detyron Komisionin për t'i dhënë hapësirë Malit të Zi, nga territori ynë. Lidhur me pyetjen se a ka Komisioni shtetëror dokumentacion tha se hulumtimi i tyre është profesional dhe shkencor, të cilin e dokumentojnë me dokumente të cilat i kanë pranë dhe drejtpërdrejt përmes monitorit. Nuk kanë asnjë dyshim në dokumentacionin dhe se harta nga Komuna e Pejës, e cila është me 70 zona të kadastrave, i ka të njëjtat zona të pandryshuara, me sipërfaqe prej 602.2 km², që i ka edhe sot, siç i kishte në vitin 1974. Sa i përket shqetësimit të qytetarëve, tha se e ndajnë shqetësimin me ta dhe se kanë kontaktuar më se 20 herë me ta dhe i kanë trajtuar shqetësimet e tyre. Lidhur me çështjen se pse është i shqetësuar komuniteti dhe nëse nuk është i shqetësuar vetëm për kullosat, z. Meha bëri të ditur se kanë dalë në terren dhe i kanë shikuar kullosat, pyjet dhe tokat, por për t'u përcaktuar një kufi duhet të analizohet dokumentacioni. Komisioni e ka për detyrë ta mbledhë dokumentacionin, duke filluar nga koordinatat, skicat,

projeksioni, rilevimet gjeodezike dhe vendosjen e pikave në terren, që nuk ka filluar ende. Puna nuk ka mbaruar ende, tha ai. Puna mbaron kur shënohet në kufi, në terren me pika të forta dhe kërkoi nga kushdo qoftë që mund të gjejë ndonjë dokumentacion më tepër se që ka Komisioni, do të ishte i mirëseardhur dhe do të trajtohej. Lidhur me pyetjen se cilat janë pikat e referencës së kufijve, ai njoftoi se referencë janë koordinata, matja, fletoret e matjes, hartat e punuara në periudha të caktuara kohore dhe pikërisht ajo e vitit 1974. Njoftoi se pa referenca, nuk mund të caktohen kufijtë dhe se këto referenca të cilat i kanë, janë të sakta. Pronat shtetërore dhe private të territorit të Republikës së Kosovës, prej 10887km², janë të gjitha të regjistruara në kadastër. Arseja e reagimit të qytetarëve është se ato territore janë shfrytëzuar për kullosa të bagëtisë së tyre, kur kanë shkuar atje, për të cilat kanë paguar tatime në Rozhajë.

Enver Hoxhaj – Tha se e drejta në pronë dhe kufiri shtetëror, janë dy çështje të ndryshme dhe asnjë pronë e qytetarëve të Kosovës, aktualisht nuk prek vijën kufitare në thellësi.

Murat Meha – Njoftoi se nuk ka lëvizje të kufirit. Kufiri është i njëjtë, dhe se kjo mund të dokumentohet nga kushdo dhe kurdo nga ne, por edhe në mënyrë të pavarur në Pejë, në zyrat kadastrave, në zyrat e pronave dhe do të shihet se ku është kufiri. Lidhur me kufirin me shtetet e tjera, z. Meha tha se ka mbetur pa u përcaktuar kufiri me Serbinë, i cili është 360km² në zgjatje dhe duhet të demarkohet, në mënyrë identike, në bazë të dokumentacionit që e ka Kosova, me saktësi centimetrike. Bëri të ditur se pas Marrëveshjes së Brukselit, kanë qenë në gjashtë pikat e vendkalimeve kufitare, i kanë përcaktuar vendkalimet kufitare në Jarinjë, Bërnjak, Muçibabë, Merdare etj. dhe saktësia ka qenë centimetrike.

Enver Hoxhaj – Në diskutimin e tij, pos tjerash, theksoi se shqetësimi qëndron me një atlas pedologjik, i cili jep dy pika, të cilat dallojnë, njëra është tek Kulla e tjetra tek Rozhaja. Pos njoftimit nga z. Meha, se Komuna e Pejës ka 70 zona të kadastrave, ka territorin e njëjtë prej 602.2 km², i cili territor është edhe sot. Ai kërkoi një qartësi lidhur me Kullën e Rozhajën, se cilat janë opinionet e profesionale të Komisionit për këto dy pika.

Murat Meha – Bëri të ditur se ekzistojnë tre atlasë të ndryshëm, të periudhave të ndryshme. Atlasi pedologjik, i cili përdoret për këtë çështje, aspektin teknik nuk e plotëson. Atlasi tjetër është i vitit 1974, për ujërat e pjesës së Dukagjinit, që kufijtë i ka siç i ka Kosova sot dhe një atlas tjetër me harta, i cili i ka hartat, siç i kemi edhe ne sot. Z. Meha theksoi se kërkesat e qytetarët janë deri tek Kulla dhe deri në Çakor. Atlasi pedologjik e paraqet vijën e cila është e përkufizuar dhe nuk ka shumë ngjashmëri me vijën që e kemi ne në pronat dhe kufirin e Kosovës. Njoftoi se kanë qenë në Çakor, në pikën më të lartë, me qytetarët dhe se nuk ka asnjë dokument i cili është gjetur që tregon diç më shumë për pronat e tyre, ose për pronat që mund të jenë të Republikës së Kosovës.

Shaban Guda – Po ashtu, theksoi se shqetësimi më i madh i banorëve ka qenë kryesisht me shfrytëzimin e kullosave, të cilat ata në të kaluarën i kanë shfrytëzuar ato, ngase nuk ka pasur kufi dhe kanë dëshmi se ia kanë paguar taksën Komunës së Rozhajës. Ai njoftoi se me Malin e Zi, mes tjerash, është arritur edhe Marrëveshja për regjimin e trafikut lokal, e cila do t'ju mundësojë të gjithë atyre që i kanë shfrytëzuar në të kaluarën këto prona, t'i shfrytëzojnë këto kullosa edhe më tej, të kalojnë kufirin jashtë pikave të kufirit, aty ku atyre u konvenon dhe të qëndrojnë 90 ditë brenda 180 ditëve, pa asnjë pasojë dhe pa dokumente. Taksa për shfrytëzimin e këtyre pronave, iu takon atyre që u takon prona.

Komisioni, pas raportimit të përfaqësuesve të Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Kërkohe nga Komisioni Shtetëror për Shënjimin e Kufirit, që të sjellë në Komision një raport me shkrim, i cili sqaron dilemat për dy pikat kufitare në Kullë dhe Rozhajë.

4. Të ndryshme

a) Lidhur me raportimin e ministrave gjatë këtij sesiioni pune të Kuvendit, me propozim të anëtarëve, Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Gjatë këtij sesiioni pune të Kuvendit, të ftohen për raportim në Komision, ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Hashim Thaçi dhe ministri i Ministrisë për Integritet Evropian, z. Bekim Çollaku.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Enver Hoxhaj